



RAPORT RRETH VIZITËS SË KRYETARËVE TË DEGËVE TË BSPK-së NË TURQI

Në sajë të bashkëpunimit të mirë mes BSPK-së dhe BSPSH-së, pas bisedimeve që u zhvilluan me Sindikatën më të madhe në Turqi HAK-iş, u dakordua që të thellohet bashkëpunimi ndërsindikal mes këtyre vendeve, rol të madh në këtë iniciativë pati BSPSH-ja.

Pas hartimit të programit dhe caktimit të delegacioneve nga BSPSH-ja dhe BSPK-ja, HAK-iş mori përsipër organizimin e vizitës të këtyre delegacioneve në Turqi.

Prej datës **14-20 Maj 2015**, u zhvillua vizita në Turqi, Delegacioni i BSPK-së udhëtoj me datë 14.05.2015 për në Shqipëri, ku u bashkuam me delegacionin e BSPSH-së dhe udhëtuan për në Ankara.

Delegacioni i BSPK-së ishte në këtë përbërje:

Nr.R.	Emri dhe Mbiemri	Institucioni	Funksioni
1	Haxhi Arifi	BSPK	Kryetar
2	Alush Sejdiu	BSPK	Nënkryetar
3	Asllan Rusinovci	F. Judikatura	Kryetar
4	Alush Hoti	F. Agrokompleksi	Kryetar
5	Vesel Nikqi	F. Elektrokosova	Nënkryetar
6	Rashit Mehmeti	F. Shërb. Publike	Kryetar
7	Zenun Sadikaj	Shërbimi Korrektues	Kryetar
8	Ali Vitia	Doganat	Kryetar
9	Memir Krasniqi	Kimi dhe Jometale	Nënkryetar
10	Jusuf Azemi	SPEVZ	Kryetar
11	Sanije Ismajli	Administrata	Nënkryetare
12	Sylejman Zeneli	SPKLLK	Nënkryetar
13	Fehmi Nika	Feronikeli	Kryetar
14	Muharrem Arifi	FSLSHK	Kryetar
15	Ryzhdi Baloku	BSPK	Këshilltar

Delegacioni i BSPSH-së në përbërjen e vet kishte 15 anëtar.

Me datë **17.05.2015**, në Ankara, u zhvillua takim i përbashkët mes HAK-iş, BSPSH-së dhe BSPK-së. Kryetari i BSPSH-së **z. Gëzim Kalaja** dhe Kryetari i BSPK-së **z. Haxhi Arifi**, në emër të Konfederatave relevante, falenderuan **z. Mahmut Arslan** Kryetar i HAK-iş, për bashkëpunimin dhe interesimin e tij për avancimin e bashkëpunimit edhe më tej mes BSPSH-së dhe BSPK-së, vlerësuan se kjo është një ndihmes e madhe për ne, këtë e dëshmon edhe takimi i sotëm por edhe takimet në të ardhmen të cilat takime do të zhvillohen edhe me degët përkatëse të HAK-iş, BSPK-së dhe BSPSH-së.

Pastaj u zhvillua ceremonia e nëshkrimit të **Marrëveshjes së bashkëpunimit** mes HAK-iş, BSPK-së dhe BSPSH-së nga : **z. Mahmut Arslan Kryetar i HAK-iş, z. Gëzim Kalaja Kryetar i BSPSH-së dhe z. Haxhi Arifi**

Kryetar i BSPK-së. Me këtë u hap një kapitull i ri bashkëpunimi mes këtyre sindikatave të tri vendeve për periudha afatëgjata.

Në vazhdim u zhvilluan punimet e Seminarit;

Tema: Lëvizja Sindikaliste, Objektivat, Strategjitë, Drejtësia Sociale dhe Demokracia

Panelist:

Prof Dr. Vedat Bilgin, Lektor në Universitetin e Gazit, paraqiti Gjendjen makro- ekonomike në Turqi dhe rolin e Sindikatës.

z.Vedat Bilgin, u fokusua në shqyrtimin e ndryshimeve që kanë ndodhur në Botë, ku veqoi tre parametra:

-Ndryshimet Politike,

-Ndryshimet Teknologjike dhe

-Ndryshimet Ekonomike.

Si arsye e këtyre ndryshimeve jemi në vështirësi të gjithë. Ne u ndikuar keq nga ndryshimi i industrialitetit, që ndodhi në fund të shek.XIX. Në vitin 1973 kishim krizën e naftës, në vitet 80-ta, erdhën në fuqi politikat neoliberalle.

Kjo solli ekonominë Globale, qe nga viti 2000 e këtej po shihen pasojat. Shikojmë fuqitë e mëdha që kanë krijuar shtetet e mëdha.

Si u reflektua kjo situatë tek punëtorët?

-Shikojmë se punëtori është bërë ujk për punëtorin,

-Shikojmë një përplasje mes punëtorëve që janë në sindikatë dhe atyre që nuk janë në sindikatë,

-Shikojmë shkëputjet mes të punësuarëve dhe të papunësuarëve.

Gjatë shek XX, prodhimi ishte në vështirësi.

Në shek XXI, dominon konsumi. Kjo bënë që berzat e të rinjëve të pasurohen pa punuar, me këtë logjikë të rinjëve jetojnë vetëm në baz të imazhit.

Në këtë situatë kushtet e punës nuk përputhen me Standardet Ndërkombëtare. Andaj nevojitet një solidaritet dhe bashkëpunim i sindikatave për përballimin e situatës.

- **Osman Yildiz ,Sekretari i Përgjithëshëm** i HAK-iş,Kryetarja e Rrjetit të Gruas dhe Përgjegjësja për informim, paraqitën të dhënat dhe aktivitetet e HAK-iş.

Në bazë të të dhënave që u paraqitën, u pa se Konfederata HAK-iş ishte e fuqishme, kishte 1 milion anëtarë dhe deri në fund të këti viti do ta arrij numrin e anëtarësisë në 2 milion veta. Kishte të arritura në mbrojtjen e të drejtave të punëtorve dhe ishte e anëtarësuar në shumë sindikata Ndërkombëtare.

- **Alush Sejdiu – BSPK-ë,** paraqiti sfidat dhe vështirësit e themelimit të sindikatave të pavarura në Kosovë në vitet e 90-ta. U przentuan reprezaljet, torturat etj që prejtuan punëtorët kosovarë gjatë masave të dhunëshme në Kosovë, nga regjimi Serb gjatë viteve 90-ta.

Po ashtu u prezentua organizimi aktual i BSPK-së, përfaqësimi në KES si dhe të arriturat e BSPK-së rreth nxjerrjes së ligjeve bazike, të cilat rregullojnë marrëdhënjet e punës, organizimin sindikal, organizimin e greveave, MPKK etj.

- **Znj.Hikmete Daja – BSPSH-ë,** po ashtu paraqiti aktivitetet, organizimin, sfidat dhe të arriturat e BSPSH-së prej themelimit e gjerë me tani.

Me këtë përfundoj sesioni i parë i Seminarit.

Në sesionin e dytë panelist ishin:

Hysein Ūz –Këshilltar ligjor i HAK-iş,

Ariola - BSPSH dhe

Ryzhdi Baloku BSPK

Tema: Ligji i Punës, MPKK, Teknika e negociatave.

Përfqaësuesit e të tri subjekteve prezentuan praktikatat dhe përvojat e tyre, nepër vendet e tyre rreth temave të lartëpërmendura.

Për të gjitha aktivitetet ka edhe imazhe fotografike, te cilat besoj se do të paraqiten në faqen e internetit të BSPK-së. Punimet e Seminarit përfunduan në orën 18:30.

Me datë 18.05.2015, vizitua selin e HAK-iş ku na priti Kryetar z.Mahmut Arslan me stafin e tij, pritja ishte vëllazërore, aty pam kushtet në të cilat punonin aktivistët, stafi dhe përfaqësuesit sindikal, kushtet ishin tejet të mira, të cilat tregonin edhe fuqinë e HAK-iş.

Pastaj me autobusin e HAK-iş, udhëtuam për në Stamboll.

Me datë 19.05.2015, në Stamboll na priti Kryetari i Sindikatës së HAK-iş për Stambillin, i cili për delegacionet e sindikatave organizoi darkë pune.

Gjatë vizitës në Turqi, vizitua monumente historike dhe kulturore që në Turqi janë të shumta. Konstatimi ynë është se kjo vizitë ishte tejet e rëndësishme për ne, ku u njohem me përvoja të reja, e veçanta e kësaj është, se u hap mundësia që bashkëpunimi në mes të tri Konfederatave të avancohet edhe më, në vazhden e këti projekti do të organizohen edhe dy takime, një në Elbasan dhe një në Prishtinë.

Me datë 20.05.2015, nga Stambolli u kthyem në Prishtinë.

Datë: 22.05.2015

Prishtinë

Raportin e përpiloi

Alush Sejdiu N/Kryetar i BSPK-së